

Data: 16.07.2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “ FURNIZIM DHE INSTALIM TRANSFORMATOR
FUQIE 13.8/245 KV,170 MVA PËR AG1 NË HEC KOMAN ”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 329,168,000 (Treqind e njëzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.ose 3,512,249 (Tre milionë e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e nëntë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 16.07.2026 është 93.72 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

vetëdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe ne përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit :

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, AK synon të sigurojë se operatori ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar shërbime apo produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Përvojat e mëparshme në kryerjen e furnizimeve të ngjashme janë një indikator i rëndësishëm i aftësisë së operatorëve për të menaxhuar projekte dhe për të përmbushur afatet dhe standardet e kërkuara. Nëse një operator ka një histori të suksesshme të realizimit të kontratave të ngjashme, kjo ul mundësinë e dështimit të kontratës së re, duke e bërë procesin më të sigurt dhe më të besueshëm për palën kontraktuese.

Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që kërkohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për projekte që kërkojnë cilësi të lartë dhe përputhje me standardet. Përvoja e mëparshme tregon se operatori ka kapacitetin për të siguruar cilësinë dhe të përmbushë kërkesat kontraktuale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

-  SSH/EN/ISO 9001: - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
-  SSH/EN/ISO 14001: - “Sistemi i menaxhimit të mjedisit
-  SSH/EN/ISO 45001: - “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata mundëson një menaxhim të mirë të cilësisë, mbrojtje të mjedisit dhe siguri të punonjësve.

Konkretisht:

a) SSH/EN/ISO 9001: – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Kërkesa për certifikimin sipas standardit SSH/EN/ISO 9001: garanton që operatori ekonomik zbaton një sistem të konsoliduar të menaxhimit të cilësisë në të gjitha fazat e realizimit të kontratës, duke përfshirë projektimin, përzgjedhjen dhe furnizimin e materialeve, proceset e prodhimit, kontrollin e cilësisë, kryerjen e testimeve, dokumentimin teknik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve. Zbatimi i këtij sistemi redukton mundësinë e moskonformiteteve teknike dhe rrit besueshmërinë e pajisjes që do të furnizohet.

b) SSH/EN/ISO 14001: – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Procesi i prodhimit, transportit dhe instalimit të transformatorëve të fuqisë përfshin përdorimin e vajrave izolues, materialeve metalike, materialeve izoluese, bojërave dhe proceseve industriale që mund të kenë ndikim në mjedis. Certifikimi sipas standardit SSH/EN/ISO 14001: garanton që operatori ekonomik administron në mënyrë të kontrolluar aspektet mjedisore të veprimtarisë së tij, minimizon ndikimet negative në mjedis, menaxhon mbetjet në mënyrë të përshtatshme dhe respekton kërkesat ligjore dhe rregullatore në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

c) SSH/EN/ISO 45001– Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Prodhimi, transporti, montimi, testimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë përfshijnë procese me rrezik të lartë industrial, si manipulimi i pajisjeve me përmasa dhe pesha të

konsiderueshme, punimet mekanike, testimet elektrike në nivele të larta tensioni dhe trajtimi i materialeve izoluese. Certifikimi sipas standardit SSH/EN/ISO 45001: garanton që operatori ekonomik ka implementuar masa dhe procedura efektive për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve profesionale, mbrojtjen e punonjësve dhe sigurimin e një mjedisi pune të sigurt gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e këtyre certifikatave lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është proporcionale me rëndësinë, kompleksitetin teknik dhe vlerën e investimit. Zbatimi i sistemeve të certifikuara të menaxhimit garanton një nivel më të lartë kontrolli të proceseve, siguron cilësinë e pajisjes së furnizuar, redukton rrezikun e defekteve dhe kontribuon në funksionimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe afatgjatë të transformatorit të fuqisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026, minimalisht 1 (një) inxhinier Mekanik dhe 1 (një) Inxhinier Elektrik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Diplomë e inxhinierëve;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Prill 2026 - Qershor 2026.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Objekti i kësaj procedure prokurimi "Furnizim dhe instalim transformator fuqie 13.8/245 kV, 170 MVA për AG1 në HEC Koman" nuk konsiston vetëm në furnizimin e një pajisjeje, por përfshin një sërë procesesh teknike të ndërvarura, si transporti, shkarkimi, montimi,

instalimi, lidhja me sistemet ekzistuese, kryerja e testeve, komisionimi dhe vënia në punë e transformatorit të fuqisë.

Realizimi i këtyre proceseve kërkon angazhimin e personelit teknik me njohuri specifike në fushat elektrike dhe mekanike, me qëllim koordinimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha fazave të zbatimit të kontratës.

Inxhinieri Elektrik është i domosdoshëm për realizimin e detyrave si:

- verifikimi i përputhshmërisë së parametrave elektrikë të transformatorit me kërkesat teknike të projektit;
- mbikëqyrja e instalimeve dhe lidhjeve elektrike në anën 245 kV dhe 13.8 kV;
- kontrolli i qarqeve të komandimit, mbrojtjes, sinjalizimit dhe ndërfaqeve me sistemet ekzistuese;
- mbikëqyrja e kryerjes së testeve elektrike gjatë fazave FAT (Factory Acceptance Test), SAT (Site Acceptance Test) dhe testeve pas instalimit;
- pjesëmarrja në procesin e komisionimit dhe vënies në punë të transformatorit.

Inxhinieri Mekanik është i domosdoshëm për realizimin e detyrave si:

- mbikëqyrja e transportit, shkarkimit dhe pozicionimit të transformatorit në vendin e instalimit;
- kontrolli i montimit të komponentëve mekanikë, përfshirë radiatorët, zgjeruesin e vajit, sistemin e ftohjes dhe aksesorët përkatës;
- verifikimi i instalimit të sistemit të ftohjes, tubacioneve të vajit, valvulave dhe pajisjeve ndihmëse;
- kontrolli i parametrave mekanikë dhe mbikëqyrja e proceseve të montimit dhe komisionimit.

Kërkesa për disponimin e këtij personeli teknik është në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, pasi transformatori i fuqisë është një pajisje kritike për funksionimin e HEC Koman dhe kërkon ekspertizë të kombinuar elektrike dhe mekanike gjatë gjithë ciklit të realizimit të kontratës.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe synon vetëm garantimin që operatori ekonomik disponon kapacitetin profesional minimal të nevojshëm për realizimin e sigurt, cilësor dhe brenda kërkesave teknike të kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 5 (pesë) punonjës të çertifikuar me kategorinë e sigurimit teknik, të çertifikuar me kategorinë e sigurimit teknik Grupi IV, lëshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurtisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- ✚ Kontratat e punës të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Prill 2026 - Qershor 2026.
- ✚ Çertifikatat/ kartelat përkatëse, të vlefshme të sigurimit teknik.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë. Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin punime me kompleksitet të lartë teknik, të cilat përfshijnë ndër të tjera çmontimin e transformatorit ekzistues, instalimin e transformatorit të ri të fuqisë 13.8/245 kV, realizimin e lidhjeve elektrike, testimet dhe vënien në punë të pajisjes në një impiant elektroenergjetik me nivel të lartë tensioni. Punimet do të zhvillohen në një ambient ku ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme elektrike, për shkak të pranisë së pajisjeve të tensionit të lartë, dhe kërkojnë zbatim strikt të procedurave të sigurisë, përfshirë masat e izolimit, tokëzimit, kontrollit të mungesës së tensionit dhe përdorimit të pajisjeve mbrojtëse. Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë minimalisht 5 (pesë) punonjës teknikë të pajisur me Kartelë Personale të Sigurimit Teknik, Kategoria IV, e cila dëshmon se personeli ka marrë trajnimin dhe kualifikimin e nevojshëm për të kryer punime në instalime elektrike dhe për të zbatuar kërkesat teknike të sigurisë gjatë ndërhyrjeve në pajisjet elektroenergjetike.

Personeli i pajisur me këtë kualifikim zotëron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme lidhur me:

- rregullat e sigurimit teknik gjatë punimeve në instalime elektrike;
- procedurat e çkqçjes, izolimit dhe tokëzimit të pajisjeve;
- masat mbrojtëse ndaj rrezikut elektrik;
- përdorimin korrekt të pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive;
- ndërhyrjet dhe punimet në ambiente me tension të lartë.

Numri minimal prej 5 (pesë) punonjësish teknikë është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, nevojën për organizimin e skuadrave të punës, realizimin paralel të proceseve të montimit dhe lidhjeve elektrike, si dhe garantimin e mbulimit të vazhdueshëm me personel të kualifikuar gjatë fazave të zbatimit të kontratës. Ky kriter është proporcional me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi synon vetëm të sigurojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin minimal profesional dhe personelin e autorizuar për realizimin e punimeve në kushte të sigurta, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe praktikat e sigurimit teknik për instalimet e tensionit të lartë.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) Inxhinier Elektrik të certifikuar nga prodhuesi ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, për instalimin dhe komisionimin e pajisjeve monitoruese DGA dhe monitorimin e izolatoreve kalimtare.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- + Kontratë pune të vlefshme;
- + Diplomat e inxhinierëve;
- + Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Prill 2026 - Qershor 2026.
- + Certifikatën e trajnimit/kualifikimit nga prodhuesi i pajisjeve monitoruese ose certifikatë ekuivalente nga një autoritet i autorizuar/certifikuar.

Shënim: Në lidhje me inxhinierin e kërkuar në këtë kriter mund të plotësohet edhe nga inxhinieri i kërkuar në kriterin 2.3.3.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Ky kriter është vendosur me qëllim garantimin që operatori ekonomik disponon personel teknik të specializuar dhe të kualifikuar për realizimin e ndërhyrjeve në sistemet ekzistuese të monitorimit online të transformatorit, të cilat përfshijnë pajisjet DGA (Dissolved Gas Analysis) dhe BMT (Bushing Monitoring Technology). Objekti i kontratës përfshin jo vetëm furnizimin dhe instalimin e transformatorit të fuqisë, por edhe demontimin, ruajtjen, riinstalimin, rikonfigurimin, rikomisionimin dhe integrimin e pajisjeve ekzistuese të monitorimit të transformatorit në sistemin funksional të HEC Koman. Këto sisteme përbëjnë një element të rëndësishëm të diagnostikimit të gjendjes së transformatorit, pasi mundësojnë monitorimin në kohë reale të parametrave kritikë të pajisjes dhe identifikimin e hershëm të anomalive ose defekteve të mundshme. Sistemi DGA realizon monitorimin e gazrave të tretur në vajin izolues të transformatorit, ndërsa sistemi BMT monitoron gjendjen dhe performancën e izolatorëve kalimtarë, duke siguruar informacion të rëndësishëm për vlerësimin e gjendjes së izolacionit dhe funksionimin e sigurt të transformatorit. Ndërhyrjet në këto sisteme kërkojnë njohuri dhe eksperiencë specifike teknike, veçanërisht për:

- çmontimin dhe ruajtjen e pajisjeve pa cenuar sensorët, modulet elektronike dhe komponentët e komunikimit;
- instalimin mekanik dhe elektrik sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- konfigurimin e parametrave të matjes dhe komunikimit;
- kalibrimin dhe verifikimin e saktësisë së matjeve;
- rikomisionimin dhe integrimin me sistemet ekzistuese të monitorimit dhe kontrollit të HEC Koman.

Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë të paktën një inxhinier elektrik të trajnuar dhe të certifikuar për këto sisteme, me qëllim garantimin e realizimit korrekt të punimeve dhe ruajtjen e funksionalitetit, saktësisë dhe besueshmërisë së sistemeve të monitorimit pas instalimit të transformatorit të ri. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është proporcionale me kompleksitetin teknik të pajisjeve që do të ndërhyhen. Sistemet DGA dhe BMT kanë rol të rëndësishëm në sigurinë operative dhe monitorimin afatgjatë të transformatorit, ndaj çdo ndërhyrje e pakualifikuar mund të sjellë konfigurim të gabuar, humbje të të dhënave monitoruese ose cenim të funksionimit të sigurt të pajisjes. Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e një inxhinieri elektrik të certifikuar për sistemet DGA dhe BMT konsiderohet e nevojshme, e arsyeshme dhe në përputhje me natyrën, rëndësinë dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë letër mbështetëse (Support Letter) nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i sistemeve të monitorimit të transformatorëve DGA (Dissolved Gas Analysis) dhe BMT (Bushing Monitoring Technology).

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur me qëllim garantimin që operatori ekonomik disponon mbështetjen teknike dhe aksesin në njohuritë e specializuara të nevojshme për realizimin korrekt të punimeve që lidhen me sistemet e monitorimit të transformatorit DGA (Dissolved Gas Analysis) dhe BMT (Bushing Monitoring Technology). Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin jo vetëm furnizimin dhe instalimin e transformatorit të fuqisë, por edhe ndërhyrjet e nevojshme në sistemet ekzistuese të monitorimit të transformatorit në HEC Koman, të cilat janë pjesë integrale e sistemit të diagnostikimit dhe mbikëqyrjes së gjendjes së pajisjes. Sistemet DGA dhe BMT kanë një rol të rëndësishëm në monitorimin e parametrave kritikë të transformatorit, pasi mundësojnë analizimin e gjendjes së vajit izolues, identifikimin e pranisë së gazrave të tretur në vaj dhe monitorimin e gjendjes së izolatorëve kalimtarë. Funksionimi i saktë i këtyre sistemeve ndikon drejtpërdrejt në zbulimin e hershëm të defekteve dhe në garantimin e operimit të sigurt dhe afatgjatë të transformatorit. Ndërhyrjet në këto sisteme kërkojnë njohuri të posaçme teknike mbi pajisjet e prodhuesit, procedurat e instalimit dhe konfigurimit, kodet e servisit si dhe akses në dokumentacionin teknik dhe mbështetjen e specializuar të prodhuesit ose distributorit të autorizuar.

Paraqitja e letrës së mbështetjes garanton që operatori ekonomik:

- disponon asistencën teknike të nevojshme nga prodhuesi ose distributori i autorizuar;
- ka akses në dokumentacionin teknik, procedurat e konfigurimit dhe komisionimit;
- mund të sigurojë ndërhyrje të kryera sipas kërkesave dhe rekomandimeve të prodhuesit;
- garanton mbështetje teknike gjatë zbatimit të kontratës dhe periudhës së garancisë.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është proporcional me kompleksitetin teknik të sistemeve DGA dhe BMT, pasi synon të minimizojë rrezikun e ndërhyrjeve të pasakta, konfigurimit të gabuar ose humbjes së funksionalitetit të sistemeve

të monitorimit të transformatorit. Për rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e një letre mbështetëse nga prodhuesi ose distributori i autorizuar konsiderohet e nevojshme, e arsyeshme dhe në përpjesëtim me natyrën, rëndësinë teknike dhe kërkesat e objektit të prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose deklaratat e markimit CE/SSH, të cilat vërtetojnë se prodhuesi është në përputhje me kërkesat e sigurisë sipas standardeve europiane dhe shqiptare.

Argumentimi: Ky kriter është i përshtatshëm dhe proporcional me objektin e kontratës dhe zbatohet në përputhje me nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ai siguron që produktet e ofruara në procedurën e prokurimit të jenë të prodhuara në përputhje me kërkesat dhe standardet përkatëse.

Vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së transformatorit i fuqisë objekt i kësaj procedure prokurimi. Markimi CE shërben si dëshmi e qartë se pajisjet janë të përshtatshme për përdorim në tregun evropian dhe se ato janë prodhuar dhe testuar sipas standardeve të njohura për cilësi dhe siguri për pajisjet elektrike të kësaj kategorie.

Transformatori objekt i kontratës është një pajisje kritike për funksionimin e sistemit elektroenergjetik, e cila duhet të garantojë siguri, besueshmëri dhe performancë të qëndrueshme gjatë gjithë ciklit të saj të operimit. Për këtë arsye, është e nevojshme që proceset e projektimit, prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe testimit të realizohen në përputhje me kërkesat e standardeve teknike të njohura ndërkombëtarisht.

Paraqitja e certifikatave ose deklaratave të markimit CE/SSH, kur është e aplikueshme, dëshmon se produkti është vlerësuar nga prodhuesi për përputhshmërinë me kërkesat përkatëse të sigurisë, shëndetit dhe mbrojtjes së përdoruesit, si dhe se janë zbatuar procedurat e nevojshme të kontrollit dhe verifikimit gjatë procesit të prodhimit.

Gjithashtu, deklaratat e konformitetit me standardet teknike shqiptare dhe/ose ekuivalente ndërkombëtare, sigurojnë që transformatori është projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat teknike për pajisjet e tensionit të lartë, duke përfshirë kërkesat për izolimin, qëndrueshmërinë elektrike, performancën termike, sigurinë në operim dhe testimet e nevojshme.

Ky dokumentacion i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë që:

- transformatori i propozuar është një produkt i kontrolluar dhe i prodhuar sipas standardeve të njohura;
- janë zbatuar kërkesat teknike dhe procedurat e kontrollit të cilësisë nga prodhuesi;
- pajisja është e përshtatshme për funksionim të sigurt dhe afatgjatë në kushtet e operimit të HEC Koman.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është proporcionale me rëndësinë, kompleksitetin teknik dhe vlerën e investimit, pasi synon të reduktojë rrezikun e

furnizimit me pajisje që nuk përmbushin kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Për rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e certifikatave/deklaratave të markimit CE/SSH ose dokumenteve ekuivalente të konformitetit konsiderohet e nevojshme dhe e arsyeshme për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe besueshmërisë së transformatorit të fuqisë që do të furnizohet.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, çertifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e një Autorizimi nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi është një kërkesë që ka si qëllim të sigurojë se operatori ekonomik ka akses dhe mund të ofrojë produkte të cilësisë së garantuar dhe të sigurta, si dhe të konfirmojë që ato janë në përputhje me standardet e prodhuesit ose distributorit.

2.3.9 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/katalogëve teknikë për mallrat objekt prokurimi justifikohet nga nevoja për verifikimin e përputhshmërisë së plotë të produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Duke qenë se mallrat kanë karakter teknik dhe duhet të integrohen me sistemin ekzistues, katalogu shërben si mjet zyrtar për identifikimin e karakteristikave teknike, parametrave dhe performancës së tyre, në

mënyrë që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë në mënyrë objektive nëse produkti i propozuar përmbush kërkesat e vendosura.

Kërkesa që në katalog të shënohen qartë dhe në mënyrë të dallueshme artikujt e ofruar dhe specifikimet përkatëse synon të shmangë paqartësitë dhe interpretimet e ndryshme, duke siguruar transparencë dhe krahasueshmëri të ofertave. Kjo i mundëson Autoritetit Kontraktor të bëjë një vlerësim teknik të saktë dhe të verifikueshëm, duke garantuar që malli i furnizuar është në përputhje të plotë me kërkesat teknike dhe standardet e kërkuara në procedurën e prokurimit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve tip të kryera për transformatorë me fuqi mbi 150MVA dhe nivel tensioni mbi 220 kV të prodhuar më parë nga prodhuesi, të lëshuara nga prodhuesi ose nga laboratorë/institucione të autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter është kërkuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", si dhe me nenin 40, pika 6, shkronjat **b)** dhe **c)**, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të paraqesin dëshmi që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: **b)** fotografi ose katalogë teknikë dhe/ose **c)** dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, të cilat vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ky kriter ka për qëllim garantimin e AK-së që prodhuesi i transformatorit ka eksperiencë të provuar në projektimin dhe prodhimin e transformatorëve të fuqisë me karakteristika të ngjashme me transformatorin objekt të kësaj procedure dhe se projekti i ofruar bazohet në teknologji të testuara dhe të verifikuara sipas standardeve ndërkombëtare. Transformatori objekt i kontratës është një transformator fuqie 242/13.8 kV, 170 MVA, i destinuar për përdorim në HEC Koman, ku do të operojë në mënyrë të vazhdueshme dhe do të përballojë regjime të rënda pune, si mbingarkesa, lidhje të shkurtra, mbitensione atmosferike dhe komutuese, si dhe kushte specifike termike të vendit të instalimit. Për këtë arsye, është e domosdoshme që projektimi dhe teknologjia e prodhimit të jenë tashmë të verifikuara nëpërmjet testeve të kryera mbi transformatorë të të njëjtit ose të një niveli të ngjashëm tensioni dhe fuqie. Specifikimet teknike të procedurës bazohen në serinë e standardeve SSH/IEC 60076 dhe standarde të tjera shoqëruese. Paraqitja e këtyre raporteve mundëson verifikimin e aftësisë teknike të prodhuesit për të realizuar transformatorë të kësaj kategorie dhe i jep Autoritetit Kontraktor garanci shtesë mbi besueshmërinë, sigurinë dhe performancën e pajisjes që do të furnizohet. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcionale me kompleksitetin dhe rëndësinë e investimit dhe synon të minimizojë rrezikun e furnizimit me pajisje të paprovuara ose të pamjaftueshme nga pikëpamja teknike.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë në mënyrë të plotë, të saktë dhe të detajuar tabelën e të dhënave të transformatorit për tu plotësuar nga ofertuesi sipas pikës 11 të termave të referencës.

Mosplotësimi i saktë i kolonave përkatëse, paraqitja e të dhënave të paplota, kontradiktore ose mosdeklarimi i parametrave teknikë të kërkuar përbën element skualifikues

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur me qëllim garantimin që operatori ekonomik ofertues paraqet një ofertë teknike të plotë, transparente dhe të verifikueshme, duke deklaruar qartë karakteristikat teknike të pajisjes që propozon të furnizojë. Transformatori i fuqisë objekt i kësaj procedure prokurimi është një pajisje me kompleksitet të lartë teknik, e cila përfshin një numër të konsiderueshëm parametrash elektrikë, mekanikë, termikë dhe funksionalë, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në performancën, sigurinë dhe jetëgjatësinë e tij gjatë operimit. Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të deklarojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar vlerat teknike të pajisjes së ofruar për çdo kërkesë të specifikuar në dokumentet teknike. Plotësimi i kolonës “Të dhënat teknike të ofertuara” i mundëson Autoritetit Kontraktor:

- të verifikojë përputhshmërinë e ofertës teknike me kërkesat minimale të specifikimeve teknike;
- të kryejë një proces vlerësimi objektiv, transparent dhe të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë;
- të identifikojë në mënyrë të qartë karakteristikat e pajisjes së propozuar;
- të shmangë paqartësitë, interpretimet subjektive ose mospërputhjet gjatë fazës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave;
- të sigurojë që parametrat teknikë të deklaruar nga ofertuesi të jenë pjesë integrale e angazhimit kontraktor dhe të verifikueshme gjatë zbatimit të kontratës.

Deklarimi i saktë i parametrave teknikë është veçanërisht i rëndësishëm për një pajisje si transformatori i fuqisë, pasi çdo devijim ose paqartësi në karakteristikat teknike mund të ndikojë në përputhshmërinë me sistemet ekzistuese të HEC Koman, në sigurinë e operimit dhe në performancën afatgjatë të pajisjes. Mosplotësimi i tabelave teknike ose paraqitja e informacionit të paplotë, kontradiktor apo të pamjaftueshëm e bën të pamundur verifikimin e përputhshmërisë së ofertës me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe cenon parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë të lëshuar nga prodhuesi i transformatorit dhe/ose prodhuesi i vajit izolues, ku konfirmohet se vaji i ri izolues që do të përdoret në transformator është pa përmbajtje PCB (PCB Free) sipas standardit SSH/ IEC 60296.

Argumentimi Ky kriter është vendosur referuar nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar që

ofertuesi do të furnizojë mallra të besueshme, në përputhje me standardet e kërkuara, dhe që janë plotësisht të pajtueshme me kërkesat e testeve në specifikimet teknike. Ky kriter është vendosur me qëllim garantimin që vaji izolues i transformatorit të furnizohet në përputhje me kërkesat teknike, mjedisore dhe të sigurisë, duke siguruar që materiali izolues i përdorur në transformator nuk përmban Polychlorinated Biphenyls (PCB). PCB-të janë përbërje kimike organike me qëndrueshmëri të lartë në mjedis dhe me veti toksike, të klasifikuara si Substanca Organike të Qëndrueshme Ndotëse (Persistent Organic Pollutants - POPs). Për shkak të ndikimit të tyre negativ në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, përdorimi dhe menaxhimi i substancave që përmbajnë PCB është kufizuar ose ndaluar nga kuadrot rregullatore ndërkombëtare dhe europiane.

Prania e PCB-ve në vajin izolues të transformatorit do të përbente një rrezik të konsiderueshëm mjedisor dhe operacional, veçanërisht në rast të rrjedhjeve, avarive ose ndërhyrjeve të mirëmbajtjes. Gjithashtu, përdorimi i vajrave që përmbajnë PCB do të sillte vështirësi në menaxhimin, trajtimin dhe asgjësimin e vajit gjatë ciklit të jetës së pajisjes, duke rritur kostot dhe rreziqet mjedisore. Sipas specifikimeve teknike të kësaj procedure, vaji izolues i transformatorit duhet të jetë në përputhje me kërkesat e standardit IEC 60296 dhe duhet të jetë PCB Free. Për këtë arsye, kërkohet paraqitja e një deklarate zyrtare nga prodhuesi i transformatorit ose prodhuesi i vajit izolues, e cila garanton origjinalitetin e produktit dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat e përcaktuara teknike dhe mjedisore. Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi vaji izolues është një komponent thelbësor i transformatorit të fuqisë dhe ndikon në sigurinë e operimit, performancën elektrike, jetëgjatësinë e izolacionit dhe mirëmbajtjen afatgjatë të pajisjes. Kriteri është proporcional me rëndësinë dhe kompleksitetin e pajisjes që do të furnizohet, pasi synon të garantojë që transformatori i ri të jetë i pajisur me vaj izolues të sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke mbështetur kërkesat e KESH sh.a. për mbrojtjen e mjedisit dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Në zbatim të këtij urdhri, grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike për objektin në fjalë, duke u bazuar në kërkesat funksionale të impiantit ekzistues, standardet shqiptare në fuqi, standardet

ndërkombëtare IEC, si dhe kërkesat teknike të sigurisë për projektimin, prodhimin, testimin, transportin, instalimin dhe vënien në punë të transformatorit. Duke qenë se objekti i investimit konsiston në zëvendësimin e transformatorit ekzistues të fuqisë të AG 1 në HEC Koman, specifikimet teknike janë hartuar me qëllim garantimin e përputhshmërisë së plotë me parametrat elektrikë, mekanikë dhe konstruktivë të impiantit ekzistues, në mënyrë që transformatori i ri të integrohet pa ndërhyrje të konsiderueshme në infrastrukturën aktuale. Objekti i kontratës përfshin furnizimin e transformatorit të ri të fuqisë, furnizimin e pjesëve rezervë të rekomanduara nga prodhuesi, si dhe kryerjen e të gjitha punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për çmontimin e transformatorit ekzistues, instalimin e transformatorit të ri dhe përshtatjen e sistemeve ekzistuese të monitorimit dhe mbrojtjes, përfshirë sistemin MKZ, sistemin DGA dhe sistemin BMT. Kërkesat teknike janë hartuar me synimin për të garantuar një nivel të lartë të qëndrueshmërisë elektrike dhe mekanike të transformatorit, rritjen e besueshmërisë në operim, si dhe sigurimin e një jetëgjatësie sa më të madhe të pajisjes. Gjithashtu, në krahasim me transformatorin ekzistues, në specifikimet teknike është kërkuar një rritje e kapacitetit të sistemit të ftohjes. Ky përmirësim konsiderohet një kërkesë thelbësore, pasi do të mundësojë funksionimin e transformatorit në kushte optimale edhe gjatë periudhave me temperatura të larta ambientale, duke reduktuar ngarkesën termike të pajisjes dhe duke rritur sigurinë dhe besueshmërinë e operimit.

Njësia e Prokurimit